



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

**Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri,
Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion**

Mbledhja e dt. 31.07. 2007

Salla: N-225 ora 9.00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës.

Procesverbal

Morën pjesë: Ibush Jonuzi - kryetar, Bajrush Xhemaili, Mahir Yagcillar, Hatixhe Hoxha, Ilmi Ahmeti, Zef Morina Sale Berisha, Milazim Haliti, Brikena Kryeziu, Fadil Gashi, Vezira Emrush ndërsa munguan: Sllagjan Iliq, Ylber Hysa, Xhevdet Neziraj

Mbledhjen e drejtoi Ibush Jonuzi – kryetar i Komisionit, me këtë

Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara;
2. Miratimi i Projekt-rezolutës rreth ndryshimit të statusit juridik të “Trepçës”
3. Të ndryshme.

Rendi i ditës u miratua.

1. Procesverbali u miratuan me vërejtje.

2. Miratimi i Projekt-rezolutës rreth ndryshimit të statusit juridik të “Trepçës”

Ibush Jonuzi- e njoftoi se komisioni, disa here me radhë, që nga viti i kaluar ka debatuar për “Trepçën” duke kërkuar format e zgjidhjes dhe të përcaktimit të statusit të ardhshëm juridik të “Trepçës”. Ka paralajmërimet se “Trepça” e menaxhuar nga AKM-ja –UNMIK-u, gjendet para përgatitjeve për likuidimin dhe për riorganizimin në pajtim me Rregulloren përkatëse nr. 2005/48.

Institucionet Vetëqeverisëse të Përkohshme të Kosovës duhet të ndërmarrin hapa konkret këmbëngulës që të parandalojnë likuidimin dhe privatizimin e “Trepçës”, tha Ibush Jonuzi .

Ilmi Ahmeti- në vazhdim propozoi që të ndryshohet fjalia minerare me minerale si dhe të behët ndryshimi të radhitja nga pika 2 .të kaloi në pikën 3.

Brikena Kryeziu- në tekstin e rezolutës në piken 2 fjalia “të ruhet” të mbetet.

Fadil Gashi –është mirë që ti thuhet AKM-së, stop për zonat me interes nacional.

Zef Morina-me këtë material të njoftohen edhe institucionet kompetente si Qeveria, MEM-i dhe KPMM-ja.

Milazim Haliti- nëse del si tekst final , mirë është që të shpallet si zonë me interes të veçantë nacional.

Në vazhdim komisioni pas diskutimeve dhe sugjerimeve si dhe plotësimit rreth ndryshimit të statusit juridik të “Trepçës” miratoi tekstin final të rezolutës si vijon:

Në pajtim me nenin 32 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion i propozon Kuvendit të Kosovës që të miratojë Rezolutën, si vijon:

Kuvendi i Kosovës,

Duke u thirrur në Kartën e Kombeve të Bashkuara të vitit 1945, Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore të vitit 1966 dhe rezolutat e nxjerra nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, veçanërisht rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara 1803 (XVII), të cilat konfirmojnë të drejtën sovranë të të gjithë popujve mbi pasuritë dhe resurset e tyre natyrore;

Duke u bazuar në të drejtën e patjetërsueshme dhe ekskluzive të popullit të Kosovës për të shfrytëzuar lirshëm të gjitha resurset natyrore të Kosovës për nevojat e zhvillimit të vet ekonomik dhe social dhe në dobi të gjeneratave të ardhshme;

Duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e jashtëzakonshme dhe vitale të kompleksit afarist “Trepça” për ngritjen e zhvillimit ekonomik dhe social të Kosovës dhe për shfrytëzimin e potencialit të madh të resurseve minerare mbi të cilat disponon ky kompleks për nevojat e popullit të Kosovës dhe të gjeneratave të ardhshme;

Duke marrë parasysh se Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit, duke vepruar në kuadër të kompetencave të rezervuara të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, e ka klasifikuar kompleksin afarist “Trepça” si ndërmarrje shoqërore e cila sipas rregulloreve të UNMIK-ut në fuqi duhet të privatizohet ose të likuidohet;

Duke marrë parasysh faktin që para Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme për Çështje të Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit ka filluar procedura për riorganizimin,

respektivisht likuidimin e kompleksit afarist “Trepça” dhe se pritet që të emërohet një Administrator i cili do të vendosë për fatin e kompleksit afarist “Trepça”;

Duke qenë të vetëdijshëm se procedura e riorganizimit dhe likuidimit bartë në vetë një rrezik serioz për tjetërsimin e kompleksit afarist “Trepça” dhe të mjeteve të tij nën vlerën reale të tregut dhe në dëm të interesave legjitime të popullit të Kosovës; dhe

Duke e konsideruar kompleksin afarist “Trepça” si ndërmarrje me interes të veçantë publik, e cila për këtë arsye nuk mund të trajtohet si ndërmarrjet e tjera shoqërore dhe e cila nuk mund të administrohet, privatizohet, likuidohet ose në mënyrë tjetër të disponohet mbi mjetet e saj pa pëlqimin e Kuvendit të Kosovës si përfaqësuesi i vetëm dhe legjitim i popullit të Kosovës;

Nxjerr këtë

REZOLUTË

1. Kuvendi i Kosovës e cilëson kompleksin afarist “Trepça” si ndërmarrje me interes të veçantë publik dhe strategjik për Kosovën dhe për këtë arsye ky kompleks duhet të konsiderohet si ndërmarrje publike;
2. Kuvendi i Kosovës vlerëson se kompleksi afarist “Trepça” duhet të ruhet si një njësi afariste në cilësinë e ndërmarrjes publike dhe për këtë arsye nuk përkrah asnjë veprim dhe përpjekje që rezultojnë në emërimin e një administratori për riorganizimin dhe likuidimin e tërësishëm ose të pjesës së kompleksit afarist “Trepça” ose të pjesëve dhe mjeteve të këtij kompleksi;
3. Kuvendi i Kosovës fton Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm që të respektojë vullnetin e popullit të Kosovës të shprehur përmes Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës dhe kërkon nga ai që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për të klasifikuar kompleksin afarist “Trepça” si ndërmarrje publike dhe për të ndaluar menjëherë procedurën e riorganizimit dhe likuidimit të kompleksit afarist “Trepça”, përfshirë këtu edhe emërimin e administratorit;
4. Kuvendi i Kosovës mbetet i angazhuar në çështjen e kompleksit afarist “Trepça” dhe nuk përjashton marrjen e masave të tjera për të mbrojtur këtë kompleks çdo rrezik i tjetërsimit të tij, të pjesëve ose mjeteve të tij, në dëm të interesave të popullit të Kosovës.

2. Të ndryshme

Ibush Jonuzi- njoftoi komisionin se për hartimin e P/ligjit për Rregullatorin e ujrave dhe ujrave të zeza dhe mbeturinave, grupit punues ndryshohet në përberje në vend të USAID-it, zëvendësohet me anëtarin e komisionit Bajrush Xhemali.

Mbledhja përfundoi në ora 13.30.

Kryetar i Komisionit

Ibush Jonuzi

